




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Në bazë të nenit 68 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 83 të Statutit të komunës së Deçanit të datës 31.10.2008, Kuvendi Komunal, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.06.2009, miraton këtë:

## **RREGULLORE MBI TARNSPARENCËN**

### **KAPITULLI 1**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullore është:

- 1).- forcimin e transparencës së organeve të administratës komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal,
- 2).- të krijoj rregullat që mundësojnë ushtrimin sa më të lehtë të mundshëm të kësaj të drejte dhe
- 3).- të nxisë praktika të mira administrative për qasjen në dokumente zyrtare.

#### **Neni 2**

##### **Fushëveprimi**

Kjo rregullore, rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, mbledhjet e publikut, obligimin për njoftim publik, konsultimi i akteve komunale dhe pjesëmarrje e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në dokumente zyrtare të komunës.

#### **Neni 3**

##### **Përkufizimet**

Për qëllime të kësaj rregulloreje:

- 1).- **“Seancat e Kuvendit Komunal”**- janë mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit,
- 2).- **“Komitetet”**- janë organe të Kuvendit Komunal,
- 3).- **“Pjesëmarrja e publikut”**- do të thotë kyçja e qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendimmarrje të organeve të pushtetit lokal, përmes dhënies së sugjerimeve dhe propozimeve.
- 4).- **“Njoftimi i publikut”**- do të thotë afishimin e njoftimeve në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Kuvendit Komunal, publikimin e tyre në mediat lokale dhe internet për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal dhe Komiteteve,

5).- **"Tubimet publike"**- janë tubime të organizuara nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij me qëllim të njoftimit të qytetarëve me punën e organeve komunale dhe ngritjen e çështjeve të ndryshme nga banoret,

6).- **"Peticionet"**- janë kërkesa kolektive me shkrim që i adresohen Komunës respektivisht Kuvendit Komunal nga një grup interesit apo organizata, rreth së cilës do çështje që ka të bëjë me përgjegjësit e Komunës me qëllim që ajo të ndërmarrë ndonjë veprim ose të përmbahet nga ndonjë veprim,

7).- **"Konsultimi publik i akteve komunale"**- nënkupton seanca dëgjimore dhe marrjen e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të publikut para miratimit të aktit dhe

8).- **"Qasja në dokumentet zyrtare"**- nënkupton shikimi i dokumenteve zyrtare të Komunës në pajtim me Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare.

## **Neni 4**

### **Mbledhjet e Kuvendit Komunal**

**4.1** Mbledhjet Kuvendit Komunal janë të hapura për publikun dhe për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.

**4.2** Kuvendi Komunal, nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njofton publikun të paktën 7 ditë para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme, njoftimi për publikë bëhet përmes:

- Shpallja publike në vendet me të frekuentuara brenda territorit të komunës,

- Media e shkruar dhe elektronike

- Faqe e internetit të komunës

- Data e mbledhjes, kohën e mbledhjes, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës.

**4.3** Mbledhjet e Kuvendit Komunal mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht vetëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në këto raste, me vendim të arsyetuar, Kuvendi Komunal i shpallë mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.

**4.4** Të gjitha vendimet dhe aktet tjera normative të Kuvendit Komunal, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare duhet të bëhen publike një javë pas mbledhjes në të cilën janë marrë vendimet, si më poshtë:

- Shpallje publike në vend më të frekuentuara brenda territorit të komunës,

- Media e shkruar dhe elektronike lokale dhe

- Web-faqja e Komunës së Deçanit.

**4.5** Buxheti komunal dhe planet komunale janë dokumente publike. Komuna merr masa për t'i vendë në dispozicion të publikut, mjeteve të informimit dhe grupeve të interesit për çështjen që është objekt diskutimit sipas legjislacionit në fuqi.

## **Neni 5**

### **Mbledhjet e Komiteteve të Kuvendit**

**5.1** Mbledhjet e komiteteve të Kuvendit Komunal janë të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe grupeve të interesit për çështjen që është objekt diskutimit sipas legjislacionit në fuqi.

**5.2** Komitetet nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njoftojnë publikun 3 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftim për publik duhet të përmbajë: datën e mbledhjes, kohën e mbledhjes, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës.

**5.3** Të gjitha vendimet e komiteteve publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasjen në dokumentet zyrtare duhet t'i vihen në dispozicion publikut sipas kërkesës.

## **Neni 6**

### **Peticionet**

**6.1** Çdo qytetar, organizatë ka të drejtë të ushtroj peticion Kuvendit për veprimtarin dhe përgjegjësit e komunës. Peticionet duhet ti drejtohen Kuvendi Komunal dhe dorëzohen në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit. Një peticion duhet të jetë i nënshkruar nga më shumë se **50** persona të regjistruar në listën e votuesve. Kuvendi i komunës duhet t'a shqyrtojë çështjen.

**6.2** Kryesuesi i Kuvendit çdo peticion të vlefshëm duhet t'ia paraqesë Kuvendit Komunal brenda 2 muajve nga dita e pranimi ose në takimin e radhës së Kuvendit. Kuvendi Komunal është i obliguar që t'i shqyrtojë peticionet dhe të marrë vendim brenda 6 javësh nga paraqitja e tij.

**6.3** Me peticion të parashtruar mund të trajtohet secila çështje që është në interes të qytetarëve në kuadër të kompetencave të komunës.

**6.4** Në rastet kur peticioni lidhet me çështjet të cilat nuk janë në kompetencë të komunës, Kryesuesi i Kuvendit brenda afatit të përcaktuar në nenin 6.2 i njofton me shkrim parashtruesit e peticionit se është jokompetent për shqyrtimin e peticionit dhe të njëjtin ja përcjellë organit kompetent.

**6.5** Peticioni duhet i përmbaj gjeneralitetet si dhe adresën e organizatorit, emrat, mbiemrat dhe adresën e nënshkruesve të peticionit dhe numrin personal. Peticioni duhet të përmbaj objektin e çështjes që kërkohet të shqyrtohet nga kuvendi komunal duke marrë një vendim meritore për çështjen e ngritur.

**6.6** Organizatori ose grupi mund ta merr fjalën në çdo takim të Kuvendit ose të ndonjë Komiteti ku shqyrtohet peticioni. Arsyeimi para Kuvendit apo Komitetit do të ishte një mënyrë e rëndësishme për të ndikuar në vendimin përfundimtar.

**6.7** Kuvendi Komunal brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 6.2 e sjellin vendimin. Vendimi i komunikohet organizatorit, qytetarët janë të lirë të vazhdojnë të mbrojnë qëndrimet e tyre, nëqoftëse përpjekja dështon herën e parë do të mund të iniciohet përsëri.

## **Neni 7**

### **Tubimet me publik**

**7.1** Kuvendi Komunal është obligativ të mban të paktën dy tubime me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm. Kuvendi komunal duhet të shqyrtoj mundësin për të mbajtur mbledhje shtesë në nivel sa më pranë qytetarëve (vendbanime, fshatra, lagje) për çështjen që lidhen për përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikim hapësinor, investimet, të hyrat komunal etj.

**7.2** Kuvendi Komunal, nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim informon publikun si më poshtë:

- Shpallja publike në vendet më të frekuentura brenda territorit të komunës,
- Mediat e shkruara dhe elektronike dhe
- Faqen e internetit të komunës.

7.3 Njoftimi i publikut behët të paktën 14 ditë para ditës së tubimit. Njoftimi publik sipas paragrafit të mësipërm duhet të përmbaj këto të dhëna (datën e mbledhjes, kohën e mbledhjes, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës).

7.4 Pjesëmarrja e zyrtarëve më të lartë komunal (Kryetari i Komunës, drejtori për Administratë, Shefi i Zyrës Lokale për Komunitete dhe Drejtorët e Drejtorateve komunale) është obligative.

7.5 Kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga publiku gjatë tubimit evidentohen. Kërkesat dhe rekomandimet shqyrtohen në afat prej 30 ditësh pas përfundimit të tubimit.

## **Neni 8**

### **Konsultimi publik i akteve komunale**

8.1 Te gjitha dokumentet (aktet, rregulloret dhe vendimet) e kuvendit komunal ose organeve komunale i nënshtrohen diskutimit publik para se ato të miratohen. Organi përgjegjës që propozon dokumentin cakton mënyrën e konsultimit më grupet e interesit, seancat dëgjimore për publikun dhe forma tjera të pjesëmarrjes së publikut.

8.2 Zyra përgjegjëse për informim njofton publikun 14 ditë para seancës së konsultimit publik si më poshtë:

- Shpallja publike në vend më të frekuentuara brenda territorit të komunës,
- Media e shkruar dhe elektronike lokale dhe
- Faqen e internetit të komunës.

8.3 Njoftimi publik sipas paragrafit të 8.2 të këtij neni duhet të përmbajë domosdoshmërisht (datën e mbledhjes, kohën e mbledhjes, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës).

8.4 Organi kompetent që ka propozuar aktin duhet të marrin pjesë aktivisht dhe të sqaroj përmbajtjen e aktit para publikut.

8.5 Propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve duhet të evidentohen. Propozimet shqyrtohen brenda afatit prej 15-ditësh nga përfundimi i konsultimit.

8.6 Organi që ka propozuar aktin duhet të informojë kuvendin për propozimet e dhëna në diskutim publik duke përfshirë propozimet e refuzuara si dhe ato të marra parasysh. Me rastin e miratimit të aktit, Kuvendi kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të projekt aktit.

## **KAPITULLI 2**

### **E drejta e publikut në qasjen në dokumentet zyrtare të Komunës.**

## **Neni 9**

### **Qasja në dokumentet zyrtare.**

9.1 Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në qasje të dokumenteve të organeve komunale, duke ju nënshtuar Ligjit mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, Ligjit për qasjen në dokumente zyrtare dhe Statutit të Komunës së Deçanit.

9.2 Kjo rregullore vlenë për të gjitha dokumentet që mbahen nga organet kompetente të komunës, të hartuara apo të pranuar nga këto organe, për të gjitha fushat dhe aktivitete të komunës.

9.3 E drejta nga paragrafi 9.2 të këtij neni i siguron personat fizik dhe juridik të jenë të informuar për politikën, vendimet dhe për punën e organeve komunale. Këto dokumente duhen të jenë të qasshme për publik.

#### 9.4 Dokumentet e organeve komunale janë:

-Procesvarbalet, vendimet, konkluzat, udhëzimet, urdhëresat, shkresat, dokumentat e përpiluara nga anëtarët e Kuvendit, të punëtorëve të shërbimit civil, planet e komunës, informacioni lidhur me buxhetin, shpenzimet dhe pagat e Kryetarit të Komunës, kryesuesit të Kuvendit, drejtorit për Administratë dhe Personel, Shefit i Zyres Lokale për Komunitete, Drejtorëve të Drejtorateve dhe të gjitha dokumentet e tjera që kanë karakter zyrtar në pajtim me Ligjin për qasjen në dokumentet zyrtare.

### Neni 10

#### Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare.

10.1 Kërkesa për iniciimin në qasje në dokumente zyrtare parashtrohet në formë të shkruar duke u përshkruar informacioni që kërkohet në mënyrë që komuna ta identifikojë dokumentin. Parashtruesi nuk është i detyruar t'i jap arsyet për parashtrimin e kërkesës.

10.2 Nëse kërkesa nuk është e saktë lidhur me informacionin që kërkohet, organi kërkon nga parashtruesi që të qartësojë kërkesën.

10.3 Organet kompetente komunale e kanë për obligim që në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së kërkesës që ti përgjigjen me shkrim parashtruesit të kërkesës. Nëse kërkesa refuzohet, pala e pakënaqur me përgjigje ka të drejtë ankesë, ankesa i dorëzohet Shefit për Administratë i cili duhet ta miratojë apo refuzojë ankesën në afat prej 15 ditësh.

10.4 Nëse organet komunal nuk përgjigjen brenda afatit kohorë të përcaktuar, parashtruesi ka të drejtë ta parashtojë kërkesën konfirmuese. Në rast se kërkesa konfirmuese refuzohet plotësisht apo pjesërisht, organi komunal kompetent e njofton parashtruesin me mjete ligjore që i ka në dispozicion ai/ajo (nisja e procedurës gjyqësore ose parashtrimi i ankesës para Ombudspersonit).

### Neni 11

#### Regjistrat

11.1 Komuna mban një regjistër të dokumenteve publike i cili azhurnohet dhe administrohet nga zyra përgjegjëse për informim nën mbikëqyrjen e drejtorit për Administratë.

11.2 Drejtoria për Administratë harton formularin për qasjen në dokumente dhe ndihmon personat fizik dhe juridik për të plotësuar kërkesën për qasje në dokumentet zyrtare.

### KAPITULLI 3

#### Dispozitat përfundimtare

12.1 Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit në Kuvend.

12.2 Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, çfuqizohet Rregullorja mbi Transparencën, 01.Nr.XL/5 dt.30.03.2007.

01.Nr.XXI-2

Deçan, dt.26.06.2009



Kryesuesi i Kuvendit

Jashar Dobraj